



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 dhjetor 2017
Nr. ref.: AGJ 1177/17

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI138/15

Parashtrues

“Sharr Beteiligungs GmbH” SH.P.K.

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 116/2015, të 17 qershorit 2015**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është “Sharr Beteiligungs GmbH” SH.P.K. që përfaqësohet nga Dastid Pallaska, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 116/2015, i 17 qershorit 2015, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa për revizion e parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (Ac. nr. 3128/2012, i 3 shkurtit 2015).
3. Vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 10 korrik 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 9 nëntor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 8 dhjetor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI138/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI138/15, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 15 dhjetor 2016, Kryetarja e Gjykatës emëroi gjyqtarin Altay Suroy anëtar të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Robert Carolan, i cili kishte dhënë dorëheqje nga pozita e gjyqtarit më 9 shtator 2016.
9. Më 11 janar 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
10. Më 4 shtator 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Në bazë të shkresave të lëndës, rezulton se z. S. Z. (në tekstin e mëtejshëm: i punësuar) kishte qenë i punësuar në pozitën “Shef i Kontabilitetit” në “Sharr Cem”, nga Hani i Elezit.
12. Më 4 dhjetor 2008, me Lajmërimin nr. 712 parashtruesi i kërkesës kishte njoftuar të punësuarin e tij për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, për arsye se *“kishte përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme të holla nga pagesat të cilat kishte qenë i detyruar t’iu paguante punëtorëve të parashtruesit të kërkesës”* duke keqpërdorur pozitën e Shefit të Kontabilitetit.
13. Në një datë të paspecifikuar, i punësuar i u drejtua Gjykatës Komunale në Kaçanik me kërkesëpadi lidhur me anulimin e lajmërimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe kthim në vendin e punës.
14. Më 13 prill 2010, Gjykata Komunale në Kaçanik (Aktvendimi C. nr. 214/08), detyroi parashtruesin e kërkesës që për çështjen kontestuese të paraqes në gjykatë përgjigjen në padi në formë të shkruar në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të padisë.
15. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi ka dërguar përgjigje në padi në Gjykatën Komunale në Kaçanik, e cila në dhjetë pika gjerësisht kundërshtonte padinë e ngritur dhe kësaj përgjigjeje si dëshmi i ka bashkëngjitur edhe ekstraktet zyrtare të “Raiffeisen bank” të cilat, sipas parashtruesit, dëshmonin pathemelësinë e padisë së ngritur ndaj tij.
16. Më 24 janar 2012, Gjykata Komunale në Kaçanik (Aktgjykimi C. nr. 214/08), miratoi në tërësi kërkesëpadinë, duke e detyruar parashtruesin që të punësuarin e tij ta kthej në vend të punës në pozitën “Shef i Kontabilitetit” me të gjitha të drejtat që dalin nga marrëdhënia e punës, si dhe e detyroi parashtruesin e kërkesës që vartësit t’ia kompensojnë shpenzimet e procedurës kontestimore.
17. Më 8 shkurt 2012, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Qarkut ndaj Aktgjykimit C. nr. 214/08, të Gjykatës Komunale në Kaçanik, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave kontestimore, vërtetim të gabuar të fakteve dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe me këtë rast kishte ngritur në ankesë edhe çështjen e legjitimitetit pasiv të palës në procedurë dhe të identitetit subjektiv të parashtruesit.
18. Më 3 shkurt 2015, Gjykata e Apelit e Kosovës (Aktgjykimi Ac. nr. 3128/12), refuzon si të pabazuar ankesën, duke vërtetuar Aktgjykimin Gjykatës Komunale në Kaçanik, C. nr. 214/08.
19. Më 23 mars 2015, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 3128/12, lidhur me pretendimin për: *“Shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe Zbatim të gabuar të së drejtës materiale”*. Ndërsa, në kërkesën e revizionit parashtruesi ka përsëritur po të njëjtat pretendime,

sikurse edhe në gjykatën e Apelit dhe kishte theksuar se gjykatat e shkallëve më të ulëta nuk kishin dhënë përgjigje në pretendimet e ngritura.

20. Më 17 qershor 2015, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Rev. nr. 116/2015), refuzon si të pabazuar revizionin sa i përket pjesës së parë të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Kaçanik, C. nr. 214/08, që ka të bëjë me anulimin e lajmërimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe në pjesën e dytë që ka të bëjë me detyrimin e parashtruesit që të punësuarin e tij ta kthejë në vend të punës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], për shkak të mosarsyetimit të vendimit gjyqësor, duke pohuar më tej se *“Si pasojë e mungesës së arsyetimit, vendimi i kontestuar e privoi paraqitësin e kërkesës nga e drejta kushtetuese për mjet efektiv juridik”*, dhe me këtë atij i është shkelur edhe e drejta e garantuar me nenin 32, dhe si pasojë e këtyre shkeljeve, parashtruesit i është cenuar edhe e drejta e pronës sipas nenit 46 [Mbrotja e Pronës] të Kushtetutës. Parashtruesi pohon gjithashtu, se ka shkelje të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] i KEDNJ-së.
22. Në kërkesën e tij parashtruesi i kërkesës ankohet për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale nga gjykatat e rregullta. Përveç kësaj, ai gjithashtu pretendon vlerësim të gabuar të gjendjes faktike, duke theksuar se *“në momentin e nxjerrjes së Vendimit të Shkallës së Parë parashtruesi i kërkesës kishte përmbyllur aktivitetin e vet si qiramarrës i Fabrikës së Çimentos “Sharr Cem” në Han të Elezit. Kjo për faktin, se në dhjetor 2010 Fabrika e Çimentos “Sharr Cem” u privatizua nga grupi Titan, me seli në Athinë të Greqisë”*. Në këtë drejtim, ai pretendon se:
- “- Vendimi i kontestuar fare nuk kishte marrë parasysh se subjekti të cilit i drejtohej Vendimi i Shkallës së Parë “Sharr Cem” SH.P.K ishte i ndryshëm nga subjekti juridik të cilit i drejtohej Vendimi i Shkallës së Dytë, Sharr Beteiligungs GmbH.*
- Gjykata Supreme legjitimon shkeljen e rëndë të ligjit material sipas të cilës ndërmarrjet private detyrohen të zbatojnë UA nr. 2003/02 për Shërbim Civil edhe pse ky instrument ligjor zbatohet ekskluzivisht për shërbyesit civil [...].*
- Vendimi i Kontestuar po ashtu ka dështuar të adresojë pretendimet faktike [...].”*
23. Parashtruesi i kërkesës përfundon duke kërkuar nga Gjykata që të deklarojë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 116/2015, dhe ta kthejë lëndën për rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

26. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

27. Përveç kësaj, Gjykata rikujton rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

28. Lidhur me si më sipër, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur një kërkesë individuale, ai ka cilësinë e palës së autorizuar, kërkesën e ka parashtruar brenda afateve të përcaktuara me nenin 49 të Ligjit dhe pas shterjes së të gjitha mjeteve juridike. Andaj, Gjykata konsideron se janë plotësuar të gjitha kushtet formale të pranueshmërisë në mënyrë që kërkesa të shqyrtohet nga Gjykata.

Vlerësimi i meritave të rastit

29. Fillimisht, Gjykata rikujton se neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] i Kushtetutës obligon Gjykatën Kushtetuese që *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, të interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*

30. Gjykata konstaton se pretendimi kryesor i parashtruesit lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut ka të bëjë me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës lidhur me nenin 6 [E Drejta për një proces të Rregullt] të KEDNJ-së dhe që sipas parashtruesit kjo shkelje ka shkakuar edhe shkeljen e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, sepse vendimet

gjyqësore nuk ishin të arsyetuara mjaftueshëm. Dispozita kushtetuese dhe e KEDNJ-së që kontestohen kanë përmbajtjen si në vijim:

Neni 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë e të Paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Neni 6 i KEDNJ-së [E drejta për një proces të rregullt]

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e Gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht”.

[...]

31. Gjykata thekson se parimisht gjatë shqyrtimit të pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ajo vlerëson nëse procesi gjyqësor në tërësinë e tij ka qenë i drejtë dhe i paanshëm, ashtu sikur edhe kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës (shih, ndër të tjera, *mutatis mutandis*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 16 dhjetor 1992, f. 34, seria A. nr. 247, dhe *B. Vidal kundër Belgjikës*, 22 prill 1992. f. 33, seria A. nr. 235).
32. Në rastin konkret, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta e kishin detyruar parashtruesin e kërkesës që të ish-punësuarin e saj të larguar nga puna për shkak të shkeljeve të supozuara disiplinore, ta kthej në ish-vendin e tij të punës, duke i shpallur si të paligjshme të gjitha veprimet juridike të parashtruesit lidhur me rastin.
33. Në dritën e pretendimeve të bëra nga parashtruesi dhe arsyetimit të dhënë nga gjykatat e rregullta, Gjykata vlerëson se është detyrë dhe juridiksion i plotë i

gjykatave të rregullta shqyrtimi i gjendjes faktike dhe vlerësimi i provave të rastit dhe se Gjykata Kushtetuese përjashtimisht, në raste konkrete ndërhyjnë vetëm atëherë kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e rregullta cenojnë të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31 i Kushtetutës) - proces të rregullt ligjor (neni 6 i KEDNJ-së). Gjykata në këto raste i analizon faktet dhe rrethanat përkatëse në atë dimension që kanë ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 31 dhe 32 të Kushtetutës.

34. Lidhur me si më sipër, Gjykata vëren se parashtruesi ka pretenduar se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 116/2015, i 17 qershorit 2015, lidhur me revizionin nuk ka respektuar standardin e arsytimit të vendimeve gjyqësore dhe, si i tillë, bie ndesh me garancitë e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së.
35. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm që garantohet me nenin 31 të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI72/12, parashtrues i kërkesës: *Veton Berisha*, Aktgjykim, i 17 dhjetorit 2012).
36. Masa deri në të cilën aplikohet obligimi për ta arsyetuar vendimin mund të ndryshoj varësisht nga natyra e vendimit gjyqësor dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. (shih *Hirvisaari kundër Finlandës*, Akgjykimi i GJEDNJ-së, 27 shtator 2001, par. 30).
37. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se Gjykata Komunale në Kaçanik në arsyetimin e Aktgjykimit të vet, në mes tjerash, ka theksuar: "*Gjykata kërkesëpadinë e miratoj si të bazuar dhe e detyroi të paditurën që paditësin ta kthej në vendin e punës ku ka punuar më parë për arsye se paditësi të paditurës "Sharr Cem" nuk i ka shkaktuar dëm me veprimet e tij, e paditura nuk e ka zhvilluar procedurën e paraparë ligjore, ka mundur që paditësit t'ia shqiptoj ndonjë masë më të butë se sa ndërprerja e marrëdhënies së punës si p. sh. vërejtja gojore, vërejtje me shkrim ndalesa e rritjes së pagës për një vit, ndalimi i avancimit si dhe uljen e të ardhurave personale e jo t'ia shqiptoj masën e fundit ndërprerja e marrëdhënies së punës, pastaj këtë masë është dashtë të vendos komisioni disiplinor i të paditurës e jo komisioni Ad-hoc".*
38. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka kundërshtuar padinë si të parakohshme duke dërguar përgjigje në padi dhe i kishte dërguar Gjykatës Komunale në Kaçanik të gjitha shkresat e procedurës disiplinore të zhvilluar kundër të punësuarit të tij, por se pretendimet e parashtruesit nga përgjigjja në padi nuk janë adresuar fare në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale.
39. Gjykata gjithashtu konstaton se parashtruesi i kërkesës pas Aktgjykimit të Gjykatës Komunale përpos bazës formale, për ankim kishte kundërshtuar at Aktgjykim edhe në substancë, duke theksuar në ankesë se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale: (a) i është drejtuar dhe obligon një subjekt juridik që nuk

ka qenë fare palë në procedurën e kontestimeve; dhe (b) nuk përmban arsye faktike dhe ligjore koherente mbi të cilat është nxjerrë. Po ashtu, në ankesë parashtruesi ka sqaruar se Gjykata Komunale në Kaçanik ka zbatuar gabimisht dispozitat e Ligjit Themelor të Punës kur ka gjetur se procedura disiplinore është e detyrueshme dhe parashihet me ligj.

40. Në Aktgjykimin Ac. nr. 3128/12, Gjykata e Apelit e Kosovës duke shqyrtuar ankesën e parashtruesit vendosi ta refuzojë ankesën e parashtruar, me arsyetimin “[...] kjo gjykatë ka vlerësuar përfundimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se i njëjti është i drejtë dhe i bazuar, se ka mbështetje në provat e zhvilluara dhe në shkresat e lëndës dhe se janë dhënë arsyet e justifikueshme të cilat edhe kjo gjykatë i pranon [...]”
Kjo gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave kontestimore për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe se gjendjen faktike e ka vërtetuar në mënyrë të plotë sikundër që e ka zbatuar drejtë dhe të drejtën materiale. [...]”.
41. Gjykata gjen se parashtruesi në Gjykatën Supreme kishte paraqitur kërkesë për revizion duke këmbëngulur në qëndrimet e veta të shprehura edhe në gjykatat e instancave më të ulëta dhe, në mes tjerash, në kërkesë kishte theksuar qartë se subjekti juridik “Sharr Cem” SH.P.K., të cilës i është drejtuar dhe të cilën e detyron Aktgjykimi i apeluar, është regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 12 nëntor 2012, pothuajse 2 (dy) vjet pasi që ishte paraqitur padia në këtë çështje kontestimore. Subjektiviteti i ndarë i “Sharr Cem” SH.P.K. nga i padituri po ashtu vërtetohet edhe nga fakti se “Sharr Cem” SH.P.K. ka numër të ndryshëm të regjistrimit të biznesit, përkatësisht 70708396, dhe numër të ndryshëm fiskal, përkatësisht 600653754, nga i padituri.
42. Parashtruesi në kërkesën për revizion gjithashtu qartazi ka theksuar se as kjo çështje e ngritur në gjykatë të shkallës së parë dhe të dytë jo vetëm se nuk është korrigjuar nga Gjykata e Apelit, por nuk është adresuar fare.
43. Gjykata vëren se Gjykata Supreme me Aktgjykimin e kontestuar ka vendosur ta refuzojë kërkesën për revizion sa i përket pjesës së parë të vendimeve gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë që kanë të bëjnë me anulimin e vendimit të parashtruesit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për një ish-punëtorë të saj, ndërsa sa i përket detyrimit të parashtruesit për t’ia siguruar punëtorit “*të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës*” vendimet gjyqësore të instancave të ulëta janë prishur dhe kthyer në rigjykim, duke e konsideruar si të paqartë dhe të papërcaktueshëm këtë pjesë të vendimeve.
44. Gjykata konstaton se parashtruesi gjatë gjithë procesit gjyqësor, në secilën instancë gjyqësore kur ka përdorur mjetet juridike ankimore të elaboruara gjerësisht si më sipër, dhe vazhdimisht kishte ngritur çështjen e vërtetimit të legjitimitetit pasiv të palës në procedurë (parimi i disponibilitetit sipas parashtruesit), duke pohuar se subjekti i paditur (parashtruesi) dhe i adresuar në vendimin gjyqësor të shkallës së parë dhe subjekti i paditur në shkallët pasuese nuk janë të njëjtë dhe se janë tërësisht të ndara. Parashtruesi, gjithashtu ka pohuar se gjykatat e instancave të ndryshme gjyqësore kanë vërtetuar në mënyra të ndryshme, madje kontradiktore, gjendjen faktike duke

mos e qartësuar faktin kyç nëse ka pasur apo jo procedurë disiplinore ndaj ish punëtorit të parashtruesit, sikur edhe faktin se cili ka qenë ligji në fuqi që duhej përdorej në këtë rast.

45. Nga përmbajtja e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme vërehet se njëri nga pretendimet kyçe, pra ai lidhur me legjitimitetin e palës ishte adresuar nga Gjykata Supreme vetëm sipërfaqësisht me një fjali, ndërsa çështja e aplikimit të ligjit në fuqi lidhur me procedurën disiplinore nuk ishte adresuar fare.
46. Gjykata Supreme sa i përket pretendimit të parë kishte theksuar *“Kjo gjykatë shton se pretendimet përkitazi me identitetin subjektiv të palës së paditur janë të pabazuara, ngase në dispozitivin e aktgjykimit të kundërshtuar është cekur se: Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës "Sharr Cem" - Sharr Beteiligungs GmbH nga Hani i Elezit, ... i cili subjekt juridik është shënuar edhe në lajmërimin e kundërshtuar të paditurës”*.
47. Lidhur me si më sipër, duket se Gjykata Supreme nuk kishte trajtuar në mënyrë meritore pretendimin e theksuar nga parashtruesi se *“vendimi i Shkallës së Parë i drejtohet dhe e detyron një subjekt juridik që fare nuk kishte ekzistuar në momentin e nxjerrjes së Lajmërimit për Ndërprerje të Marrëdhënies së Punës dhe që - si pasojë - fare nuk kishte marrë pjesë në procedurën kontestimore për këtë çështje”*.
48. Gjykata konsideron se kjo çështje është e karakterit thelbësor për rastin; andaj qartësimi i saj është i domosdoshëm aq më tepër kur parashtruesi kishte theksuar dhe paraqitur prova për dy subjekte juridike të ndara me numra të regjistrimit dhe numra fiskal të ndryshëm. Nga vendimet gjyqësore nuk mund të konstatohet nëse kishte ndonjë akt juridik mbi bartjen apo trashëgimin e obligimeve në mes të dy subjekteve juridike kështu që nuk është e qartë, nëse vërtetë subjekti i adresuar në vendime (në rastin konkret parashtruesi) është ai i duhuri, që duhet t'i bartë detyrimet juridike të urdhëruara me vendimet gjyqësore.
49. Për sa i përket pretendimit tjetër të parashtruesit lidhur me çështjen e procedurës disiplinore ndaj ish të punësuarit të saj dhe mënyrës së trajtimit të kësaj çështjeje nga gjykatat e rregullta, Gjykata konstaton si në vijim:

Gjykata Komunale në Kaçanik, në Aktgjykimin C. nr. 214/08, të 24 janarit 2012, kishte arsyetuar *“d) e paditura paditësit ja ka ndërprerë marrëdhënien e punës, pa zhvilluar kurrfarë procedure të paraparë me ligj, e këtë fakt gjykata e vërtetoi, nga lajmërimi i të paditurës me nr. 712, prej dt. 04.12.2008, ku në arsyetim të lajmërimit është shënuar se marrëdhënia e punës i është ndërprerë sipas raportit të dt. 29.11.2008 të komisionit Ad hoc”*.

50. Gjykata e Apelit e Kosovës (Aktgjykimi Ac. nr. 3128/12, i 3 shkurtit 2015), kishte arsyetuar *“Prandaj, për sa i përket pretendimeve ankimore, siç është fjala edhe për pretendimin ankimor lidhur me procedurën disiplinore, kjo gjykatë konsideron se të njëjtat janë të paqëndrueshme, kështu, sepse, me Rregulloren 2001/27 për ligjin Themelor të Punës në Kosovë, nuk është paraparë procedura disiplinore, por, kjo procedurë, është paraparë me*

Urdhëresën Administrative të PSSP-ës nr. 2003/2 për zbatimin e kësaj Rregulloreje, e cila procedurë në rastin konkret juridiko-civil, siç rezulton nga shkresat e /lëndës, nuk është zhvilluar fare”.

51. Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Rev. nr. 116/2015, i 17 qershorit 2015) kishte konstatuar: *“Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejt kanë zbatuar dispozitat e ligjit material kur kanë aprovuar kërkesëpadinë e paditësit për anulimin si të kundërligjshëm të lajmërimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe kthimin në vendin e punës, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate e paditura konform dispozitës ligjore nga neni 11.5 në rastet kur zbatohet neni 11. 2 të Ligjit Themelor të punës në Kosovë, pika (b), punëdhënësi do ta mbaj një takim me punonjësin dhe ja shpjegon me gojë shkaqet e shkëputjes së marrëdhënies së punës”.*
52. Gjykata vëren se çështja e procedurës eventuale disiplinore ndaj punëtorit të parashtruesit nga gjykatat e rregullta në tri instanca ishte trajtuar në mënyra të ndryshme, aq sa është e vështirë që nga vendimet gjyqësore të konstatohet nëse ka pasuar apo jo një procedurë disiplinore të zhvilluar. Edhe nëse ka pasur një të tillë, është e paqartë baza juridike mbi të cilën ajo është zhvilluar apo është dashur të zhvillohet. Gjykata konsideron se ka elemente kontradiktore në vendimet e gjykatave të instancave të ndryshme lidhur me këtë çështje, që gjithsesi se ka rol thelbësor në rezultatin përfundimtar të kontestit.
53. Parashtruesi qartë kishte ngritur në kërkesën për revizionin çështjen e referimit tërësisht të gabuar të Gjykatës së Apelit në UA 2003/2, duke theksuar se ky udhëzim administrativ nuk e vë në zbatim Ligjin Themelor të Punës, por Rregulloren 2001/36 për Shërbimin Civil në Kosovë. Deri sa ish-punëtori nuk kishte statusin e shërbyesit civil dhe ky UA nuk aplikohet fare në rastin e tij. Pra, parashtruesi pretendonte sy ky fakt ishte determinant për marrjen e Aktgjykimit të asaj gjykate, por se Gjykata Supreme nuk adresoi fare këtë çështje vetëm se konstatoi se *“gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejt kanë zbatuar dispozitat e ligjit material”.*
54. Sigurisht, mundësia e vendimeve kontradiktore gjyqësore është për nga natyra e mundshme në çdo sistem juridik të bazuar në një rend të gjykatave të shkallëve të ndryshme me autoritet mbi territorin e tyre. Megjithatë, roli i Gjykatës Supreme është pikërisht për të trajtuar këto kontradikta (shih S.C. Uzinexport S. A. kundër Rumanisë, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 31 marsit 2015, par. 29) shih, ndër të tjera edhe (Zielinski dhe Pradal dhe Gonzalez dhe të tjerë k. Francës [GC], nr. 24846/94 dhe 34165/96).
55. Duke vlerësuar procesin si një tërësi unike, në bazë të vlerësimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme dhe aktgjykimeve të gjykatave të instancës më të ulët, Gjykata konstaton se mungesa e adresimit të plotë të pretendimeve ,dhe dhënia e përgjigjes adekuate në tri pretendimet bazike të parashtruesit si: legjitimiteti pasiv i palës në procedurë, çështja e procedurës disiplinore ndaj të punësuarit dhe aplikimi tërësisht i gabuar i ligjit, si çështje thelbësore të procesit, përbëjnë një të metë të pakapërcyeshme të përmbajtjes së Aktgjykimit dhe arsyetimit të Gjykatës.

56. Nisur nga sa u argumentua më sipër, si dhe bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të GJEDNJ-së, në këtë drejtim, në rastin konkret në shqyrtim, Gjykata vlerëson se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme me të cilin është refuzuar revizioni nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, Gjykata konstaton se ka shkelje të nenit 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës dhe të nenit 6.1 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të KEDNJ-së.
57. Meqenëse pretendimi për shkelje të së drejtës në pronë [neni 46 i Kushtetutës] nuk ishte arsyetuar mjaftueshëm nga parashtruesi, por vetëm se ishte përmendur se ka ndodhur si pasojë e shkeljes për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata nuk gjen arsye ta shqyrtojë si pretendim të veçantë.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullat 56 (1) dhe 74 (1) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 4 shtator 2017, njëzëri:

VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- III. TA DEKLAROJË të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 116/2015, të 17 qershorit 2015;
- IV. TA KTHEJË Aktgjykimin e Gjykatës Supreme për rivendosje në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;
- V. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të zbatimit të këtij Aktgjykimi;

- VI. TË URDHËROJË që ky Aktgjykim t'u kumtohet palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare.
- VII. TË DEKLAROJË se ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Ivan Čukalović



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arteta Rama-Hajrizi